

26.08.2024

Ora, 11:16

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr.11 datë 9 gusht 2024, depozituar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, me objekt “Kundështimi i vendimit nr.85, datë 5.08.2024, “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 4.08.2024 të KZAZ-së nr.88”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa,  
z. I. Rusmali (online), z.K.Bele, z. Ledio Braho,
- **Stafi KQZ:** Z. E. Meta, z. M. Bardhi
- **Parti Politike:** Z.F.Nuri (BF), z. E. Salianji (PS)
- **Të tjerë:** S’ka

*Z. K. Bele:* Mirëdita! Riçelim seancën e ndërprerë para disa ditësh, ditën e enjte, lidhur me plotësimin e kërkesës së ankuesit, e mbështetur nga dy anëtarë. Më saktë kërkesa e dy anëtarëve të KAS-it për vënien në dispozicion të dokumentacionit të gjetur në kutitë e materialeve zgjedhore. Rikujtojmë, relatojmë që pas vendimit tonë, u krye hapja e kutive nga administrata e KQZ-së, duke nxjerrë dokumentacionin përkatës të kërkuar. Na është vendosur në dispozicion një tufë, ose më saktë disa procesverbale që reflektojnë këto gjetje. Konkretisht nga administrata e KQZ-së të na relatohet në çfarë konsistojnë dokumentacioni i cili na është vënë përpara.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

**Z. E. Meta:** Referuar vendimmarrjes suaj u hapën 36 kuti të materialeve zgjedhore, të të gjitha qendrave të votimit të KZAZ-së nr.88, Bashkia Himarë. U ngritën 4 grupe pune, 4 tavolina, në të cilët hapën kutitë dhe nxorën 4 dokumentat e kërkuar nga pala ankimuese, që janë: “Libri i protokollit të mbledhjeve”, “Regjistri i posaçëm i zgjedhësve”, “Lista e zgjedhësve” dhe “Procesverbali i mbylljes së votimit” së KQZ-së që është 00-08. Nga administrimi i të gjitha të dhënave rezultoi në përgjithësi se 169 zgjedhës janë evidentuar nga komisionet e qendrave të votimit, të cilët nuk janë lejuar të votojnë për shkak të skadimit të kartës. Dhe respektivisht 155 janë evidentuar në “Regjistrin e posaçëm të zgjedhësve” dhe 18 në “Librin e protokollit të mbledhjeve”. Shënimet e tjera...

**Z. K. Bele:** Të lutem t’i marrim me radhë, ta kuptojmë. 169 janë rastet që kanë vajtur me?

**Z. E. Meta:** Me kartë të skaduar.


**Z. K. Bele:** Pajisja PEI i ka identifikuar?

**Z. E. Meta:** Jo, komisioni.

**Z. K. Bele:** Komisioni pra, 169 qytetarë, komisioni i ka kthyer mbrapsht dhe ka mbajtur shënim për këtë qëllim.

**Z. E. Meta:** Në 18 raste këto janë evidentuar te “Libri i protokollit të mbledhjeve”, aty ku duhet të ishin evidentuar, ndërsa në 155 raste janë evidentuar te “Regjistri i posaçëm i zgjedhësve.”

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

**Z. K. Bele:** Pra, për këtë numër...

**Z. E. Meta:** Në të vërtetë “Regjistri i posaçëm e zgjedhësve” nënkupton identifikimin e zgjedhësve që kanë votuar, që janë administratë zgjedhore ose me vendim gjykate.

**Z. K. Bele:** Pra shifra është 169. Dakord. Veç kësaj çfarë kemi?

**Z. E. Meta:** Shënime gjithashtu në lidhje me një numër të madh, rreth 100 zgjedhës të cilët kanë pasur vështirësi për t’u identifikuar përmes pajisjes PFI, po të cilët janë evidentuar nga komisioni i qendrës së votimit dhe kanë votuar në përputhje me udhëzimet e KQZ-së, në “Librin e protokollit të mbledhjeve”.

**Z. K. Bele:** Pra janë rastet që nuk ka njohur gjurmën e gishtit, përgjithësisht. Pra kemi 100 raste.

**Z. E. Meta:** Ndërsa duhet thënë që jo në të gjitha rastet, në të gjitha qendrat e votimit “Lista e zgjedhësve” është përdorur, në rastet kur është përdorur nuk ka asnjë shënim që të jetë evidentuar fakti që është lejuar apo nuk është lejuar, pra është konsultuar dhe me palën paditëse lista e zgjedhësve. Gjatë momentit të këqyrjes së provave. Kopjet nuk i kemi për “Listën e zgjedhësve”, i kemi përgatitur, nuk i kemi dhënë pa një vendimmarrje të KAS-it, pasi përmbajnë të dhëna sensitive, personale.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

**Z. K. Bele:** E kuptoj. Është evidentuar në ndonjë rast apo ka ndonjë shënim apo ndonjë gjurmë të ndonjë rasti që lidhet me pretendimin për votim të zgjedhësve me karta të skaduara? Ka ndonjë gjetje të tillë?

**Z. E. Meta:** Po ka, në disa qendra votimi, në 2, 3 qendra votimi.

**Z. K. Bele:** Kanë votuar?

**Z. E. Meta:** Jo, jo , më falni nuk kemi shënime të tilla.

**Z. K. Bele:** Pra nuk kemi raste të tilla votimi nga dokumentacioni.

**Z. L. Braho:** po 2, 3 rastet çfarë ishin?

**Z. E. Meta:** Cilat raste?

**Z. K. Bele:** Se ndoshta u keqkuptuam me fjalë. Unë pyeta a ka raste që ka votuar njeri me kartë të skaduar?

**Z. E. Meta:** Jo, jo nuk ka të evidentuar.

**Z. K. Bele:** Mirë unë s'kam pyetje të tjera. Palës kërkuese i është vënë në dispozicion dokumentacioni?

**Z. M. Bardhi:** Atëherë, pas marrjes së vendimit të KAS-it, në seancën e datës 22.08.24 me hapjen e kutive të materialeve zgjedhore. Administrata, siç u relatua

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

më sipër, është vënë në dispozicion për grumbullimin e shkresave të kërkuara në seancën e datës 22.08.24. Administrata pasi shumëfishoi procesverbalin, librin e protokollit, listën e zgjedhësve të 36 qendrave të votimit siç u kërkuara nga ankuesi. Është vënë në dispozicion të ankuesit deri në orën 19.00 me orën lokale dhe asnjë person i autorizuar nuk u paraqit për marrjen e informacionit të kërkuar. Gjithashtu me datë 23.08.24 punonjësit e administratës kanë qëndruar në ambientet e punës deri në orën 18.00 me orën lokale dhe përsëri askush nuk u paraqit për të tërhequr këtë informacion. Për sa i përket pretendimeve se KQZ-ja fsheh prova dhe nuk ia vë në dispozicion ankuesit, ky pretendim bie poshtë, në kushtet kur nga 7 kërkesa vetëm 3 prej tyre disponoheshin dhe pjesa tjetër duhej ndërhyrja e KAS-it, ishte kjo e vetmja arsye e cila nuk u vu në dispozicion dokumentat e kërkuara pasi përgjigja nuk do ishte shteruese.

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Ajo që na intereson është që dokumentacioni ka qenë i gatshëm dhe është marrë sot nga pala ankuese, apo jo? Ka ndonjë pyetje nga kolegët?

**Z. L. Braho:** Kam unë një pyetje, për administratën. Nga të gjitha gjetjet ne kemi një raport këtu, gjithsesi kjo i takon ankuesit që t'i sqarojë rast pas rasti, po pati vendimmarrje të KQV-së për pjesën që duhet të votonin apo nuk duhet të votonin personat me dokumenta të skaduar, pra kishte ndonjë vendimmarrje apo?

**Z. E. Meta:** Në rastet e moslejimit është evidentuar, pra në rastin e “Librit të protokollit të mbledhjeve”, është evidentuar thjesht, nuk është lejuar për shkak se është kartë e skaduar, kaq.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

*Dt. 26.08.2024*


**Z. E. Lako:** Është marrë një kopje e provave nga pala ankuese deri në këtë moment?

**Z. M. Bardhi:** Është vënë në dispozicion pak minuta para seancës, e ka tërhequr pasi nuk janë paraqitur më parë.

**Z. K. Bele:** Atëherë vazhdojmë me palën ankuese lidhur me ato që u relatuan dhe qëndrimin tuaj për këto çfarë u relatuan nga KQZ-ja.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Faleminderit! Ne me dokumentacionin u vumë në dijeni gjatë procesit, që dolën elementët. Unë kam qenë prezent në ambientet e KQZ-së deri në përfundimin e nxjerrjes të të gjithë elementëve dhe provave, ata elementë që ishin të rëndësishëm për ne i konstatuam që në atë moment. Thjesht për të sqaruar këto pika. Në lidhje me konkluzionet, për ekonomi edhe të seancës, për të mos marrë më tepër kohë. Ne kundërshtojmë vendimin nr.85, datë 5.08.2024, të KZAZ-së nr.88 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Himarë” në zgjedhjet e pjesshme. Kemi kërkuar pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha qendrat e votimit, në 36 qendra votimi gjithsej dhe rregullimi i pasojave duke konstatuar pavlefshmërinë dhe duke shpallur përsëritjen e këtyre zgjedhjeve. Disa nga parregullsitë në zgjedhjet e 4 gushtit, të Bashkisë Himarë mbi të cilat bazohet pretendimi ynë, patjetër është diferenca midis kandidatëve, i cila është 1470 vota afërsisht. Nga kryqëzimi i të dhënave dhe i provave që kemi arritur të grumbullojmë dhe të analizojmë, problemi më i madh i zgjedhjeve të 4 gushtit në vlerësimin tonë ishte pamundësimi i votave, i mbi 26% të listës së zgjedhësve në

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

Bashkinë Himarë ose konkretisht 6157 zgjedhës të regjistruar në nga mbi 23500 zgjedhës në total, kjo pengesë për të votuar, ne e vlerësojmë...

**Z. K. Bele:** Franci për procedurë, ju po dilni në konkluzione?

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Konkluzione, po.

**Z. K. Bele:** Pra, për të konkluduar lidhur me gjetjet nga administrata ju nuk keni... Do t'i përfshini pjesë të...

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Po do t'i përfshijmë.


**Z. K. Bele:** ...lidhur me çfarë u parashtrua nga ana juaj për 500 raste.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Do t'i përfshijmë në sqarimet tona. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Më fal, për procedurë meqenëse u prezantuan si prova dhe mund të kishte ndonjë koment. Ka ndonjë gjë nga pala tjetër lidhur me këtë material të KQZ-së sepse për ekonomi po dalim tek konkluzionet. Pra, do shpreheni dhe ju në fund. Dakord.

**Z. F. Nuri, përfaqësues i Koalicionit BF:** Atëherë po e rimarr dhe njëherë fjalën që për ne kjo pengesë, pengesa për të votuar, rreth 26% të listës të zgjedhësve është një nga shkeljet më të rënda që ka ndodhur në këtë bashki. Kjo vjen si rezultat i mosveprimit nga ana e institucioneve shtetëore. Së pari duke mos marrë të njëjtat


*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

masa si të paktën 3 palë zgjedhje të shkuara, vendore apo jo, ku me anë akt normativ Këshilli i Ministrave e kishte zgjatur vlefshmërinë e letërnjoftimeve me datë skadence për efekt votimi, për t'i dhënë mundësi zgjedhësve, të votonin. Së dyti duke mos marrë masat nga ana e KQZ-së apo e institucioneve të tjera shtetërore për të bërë thirrje sensibilizuese drejtuar popullatës, pra në Bashkinë Himarë se kësaj radhe nuk kishin mundësi për të votuar, nëse nuk rinovonin kartat. Së dyti, pengimi i mundësisë së votimit nga ana e mbi 26% e totalit të zgjedhësve në Bashkinë e Himarës duhet të konsiderohet e kundraligjshme në vlerësimin tonë dhe zbatimi i standartit të dyfishtë edhe për faktin se çënon parimet themelore të sigurisë juridike nga njëra anë por edhe barazinë e votës nga ana tjetër. Për ta shpjeguar duke “lejuar” në thonjëza me ligj tre herë rresht qytetarët me dokumenta ID të skaduar. Banorët e Himarës që kishin qenë në të njëjtën situatë në maj të 2023 kishin pritshmërinë e ligjshme se edhe kësaj radhe do t'u jepej mundësia të votonin sërish, pa pengesa, sikundër edhe herët e tjera. Duke iu mohuar e drejta e votës me procedura, u zhbë e drejta e votës në vlerësimin tonë e cila është një e drejtë kushtetuese, e pakushtëzuar. Së treti nga faktet dhe provat e grumbulluara u konstatua se janë përdorur në Himarë standarde të dyfishta në procesin e votimit, ku votues të caktuar janë penguar artificialisht të votojnë apo atyre u është vështirësuar procesi i votimit, rasti i qytetarëve me karta dhe pasaporta të vlefshme por që janë nxjerrë nga sistemi sikur ishin të pavlefshme që u debatua dhe në seancat e shkuara. Nga ana tjetër në Himarë kanë rezultuar dhe raste që në vlerësimin tonë qytetarë me dokumenta të skaduar kanë pasur mundësinë që të votojnë, ashtu sikundër me vendimmarrje herë pas here të komisioneve ashtu sikundër dhe ka ndodhur edhe në zgjedhjet e pjesshme të Bashkisë së Kukësit, në shtator 2023, edhe pse nuk ka pasur akt normativ. Një tjetër problem madhor i konstatuar në Himarë, në gjykimin tonë është operacioni partiak, i mishëruar jo

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

vetëm nga përfshirja në listat e komisionerëve të PS e gati 30% të komisionerëve, nga punonjës të administratës dhe pushteti vendor apo qendror, pa autorizimin paraprak të depozituar në KZAZ sipas rregullave, por operacioni partiak në vlerësimin tonë u mishërua në Himarë edhe me rreth 256 të evidentuara ku zgjedhës të caktuar kishin arritur të rinovonin kartat e tyre në kohë rekord, 1 apo 2 ditë para zgjedhjeve të 4 gushtit, aq sa dhe pajisja PEI nuk i njihte për shkak të mospërditësimit të sistemit. Kaq janë rastet që përfaqësuesit e opozitës kanë arritur të evidentojnë në atë moment, po patjetër që numri real ka gjasa të jetë më i lartë. Pra përdorimi i standardit të dyfishtë dhe cënimi i barazisë vihet re domethënë që ka pasur një tendencë që qeveria të mos zgjasë vlefshmërinë e kartave të qytetarëve nga njëra anë, por nga ana tjetër me operacion kirurgjikal ka futur në lojë patronazhistët, pushtetin dhe çdo mënyrë tjetër për të identifikuar votuesit e tyre dhe t'u mundësonte rinovimin në kohë rekord të dokumentave. Ju kujtojmë dhe një gjë dhe një element të vogël që prej kohësh tashmë prodhimi i dokumentave është, varet jo vetëm, nuk varet nga një kompani private siç ka qenë më përpara por varet nga institucione shteti dhe kjo është një indicie tjetër në lidhje me këtë. Nga provat dhe të dhënat që arritëm të analizojmë ne i qëndrojmë shifrës prej 560 zgjedhës janë penguar të votojnë atë ditë për shkak të skadencës së dokumentave, gjithashtu nga provat dhe dokumentat që kemi arritur të grumbullojmë figurojnë 311 shtetas të shtuar në Himarë, në listat e zgjedhësve nga prilli i 2023 deri në qershor 2024. Shifër të cilës duhet t'i shtojmë dhe 93 zgjedhës të tjerë të shtuar pas datës së dekretimit të zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës, sikundër është bërë e ditur edhe nga vëzhguesit vendorë të zgjedhjeve. Një tjetër shkelje në vlerësimin tonë është ndryshimi masiv i qendrave të votimit në Himarë, duke vendosur anëtarë të familjeve të njëjta në qendra votimi të ndryshme, ku ka rezultuar edhe nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion se të paktën 1438

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

zgjedhës rezultojnë se kanë pasur probleme për identifikim. Pra janë identifikuar gabimisht, kjo shifër përfaqëson 17% të totalit të votuesve atë ditë sepse e rikujtoj kanë votuar 8500 zgjedhës në Bashkinë e Himarës, nga kjo shifër 1437 kanë pasur vështirësi në identifikimin për shkak të ndryshimeve të qendrave të votimit. Po ashtu nga të dhënat që na u vunë në dispozicion figurojnë 388 zgjedhës me verifikim pa shenja, çka përbën një tjetër problem në vlerësimin tonë. Lidhur me pavlefshmërinë është padysim neni 160 i Kodit Zgjedhor që përcakton rastet, pa dashur të zgjatem, ne përfundimisht si Koalicion “Bashkë Fitojmë” për të gjitha shkeljet e konstatuara më sipër vlerësojmë se kanë cënuar procesin e votimit në atë zonë zgjedhore në një masë të tillë sa edhe diferenca prej 1470 votash të vihet në pikëpyetje duke cënuar procesin në një masë sa të sillte dhe pavlefshmërinë e rezultatit si pasojë përsëritjen e zgjedhjeve, ndaj përfundimisht kërkojmë nga KAS pranimin e kërkesës tonë duke kundërshtuar vendimin nr.85 të KZAZ-së nr.88, “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjet e Kryetarit të Bashkisë Himarë” duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në të gjitha qendrat e votimit në zonën zgjedhore, në Bashkinë Himarë, duke rregulluar pasojat dhe duke shpallur pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe ripërsëritjen e tyre. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Faleminderit! Dëgjojmë palën, përfaqësuesin e subjektit Partia Socialiste.

**Z. E. Salianji, përfaqësues i PS:** Faleminderit! Për sa i përket këtij objekt ankimi, siç nisi ky proces, ashtu po mbyllet. Nisi një proces sa i thjeshtë në ankimim por gjatë kërkesave të palës, ishin kërkesa të cilat nuk bazoheshin në asnjë dispozitë të Kodit Zgjedhor, po KAS-i ia dha mundësinë që t’i hapte kutitë e Himarës dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

normalisht bëris shumë mirë që i hapi kutitë, që tashmë Himara mbyllet njëherë e mirë si proces, si proces politik ashtu dhe proces ligjor. U pa nga hapja e gjithë kutive të votimit që nuk kishte asnjë shkelje të ligjit, zero shkelje të ligjit dhe këtë e them dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit ligjor si dhe nga çka tha pala ankuese, që nuk përmendi një qendër votimi konkrete, me shkelje konkrete dhe me emra konkretë. Neni 160, e thamë dhe në seancën e parë, ligji kërkon shkelje ligji që të jetë konkrete, të ndodhur në një qendër votimi, me vota konkrete dhe pastaj pasojat shqyrtohen qendër pas qendre. Në rastin konkret dhe në diskutimin që bëri pala ankuese nuk iu referua asnjë qendre votimi ku ka ndodhur shkelja e ligjit. Neni 160 nuk kërkon pavlefshmëri, nuk thuhet kërkoj pavlefshmërinë e gjithë bashkisë, kërkohet pavlefshmëria e qendrës së votimit, në qoftë se kjo pavlefshmëri ndikon atëherë pavlefshmëria bëhet në të gjithë bashkinë. Do të thotë që vetë ankuesi nuk e ka kërkuar pavlefshmërinë në asnjë qendër votimi, lexohet kërkesa, pra si shkelje konkrete. Thjesht u tha kanë ngelur 6000, thotë një shifër 6000 e cila nuk është 6000, por na paska qenë 109 persona të cilët kanë vajtur: 161 persona të cilët kanë vajtur në qendrën e votimit dhe nuk kanë votuar për arsye se kanë pasur pasaportën e pavlefshme, pra gjithë kjo shifra 6000, në qoftë se do të kishim një shifër 6000, në qoftë se kjo 161 do të ishte 6000 ose do të ishte minimumi 1471 sa është diferenca, atëherë ne do diskutonim që këta 1471 që kanë vajtur në qendrën e votimit nuk kanë votuar, me të drejtë nuk kanë votuar se pasaporta është e pavlefshme. Me një patentë të pavlefshme unë nuk e di që mund t'i japësh makinës pavarësisht se ti di t'i japësh makinës shumë mirë. Ke 10 vjet që i jep makinës po ka mbaruar afati i patentës, atëherë derisa ta rinovosh nuk mund ta ngasësh makinën, pavarësisht se për 10 vjet je bërë shofer më i mirë se kur e ke marrë patentën. Ligji thotë që dokumentat, votohet me dokument të vlefshëm, megjithatë parimisht, se e drejta e votës është një e drejtë kushtetuese, në qoftë se do të kishim

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

një numër, pra ajo çka flitet 6000, 1400, mund të diskutoni që këta persona, cila ka qenë pamundësia fizike që këta persona të rinovojnë ID. Doli nga gjithë ky hetim dhe shumë mirë që u bë ky hetim, 160 se këta 160 nuk e dimë për kë kanë qenë, kanë qenë për z.Tavo apo mund të kenë qenë dhe për kandidatin tjetër. Pavlefshmëria nuk i bëhet vetëm një krahu, dokumenta të pavlefshme, pavarësisht atyre që thamë më sipër, unë do thoja që ky proces të paktën t'i shërbejë për të provuar tashmë, mbyllet saga e Himarës. Ky proces, kjo transparencë që u bë këtu, vërtetoi se në Himarë zgjedhjet ishin të drejta, jo shkelje ligji dhe këtë nuk e them unë si subjekt pjesëmarrës në zgjedhje, por këtë e thotë gjithë ky dokumentacion zgjedhor i qendrave të votimit ku në shumicë KZAZ-ja ka qenë nga Partia Demokratike. Pra, këto dokumenta këtu që japin atë ngjarje që ka ndodhur ditën e zgjedhjeve, në shkeljen e supozuar, të gjitha ndodhen këtu, në qoftë se do të kishim shkelje do të ishin këtu. Shkeljet do t'i shkruanin anëtarët e komisioneve ku gjysmën normalisht e ka ankuesi, do të kishin shkruar një shkelje, asnjë shkelje s'ka. KZAZ-në e kishin me vendimmarrje, mund të merrnin vendime dhe aty s'ka ndodhur, por ne thamë që në fillim se nuk ka ndodhur shkelje, nuk ka pasur shkelje në Himarë, procesi ka qenë shumë i rregullt, por procesi ankimor ishte një proces për të justifikuar humbjen dhe tashmë u provua qartë që ajo çka mendohej, që ishte paranoja, nuk ka ndodhur. Nuk ka ndodhur asnjë shkelje ligji, nuk kanë qenë ata 6000, mijëra persona nuk kanë votuar, 160 persona kanë shkruar, të cilët kanë shkruar me dokument, të cilin nuk e kanë pasur të vlefshëm ditën e votimit dhe ata mund të kenë qenë dhe të majtë dhe të djathtë, këtë ne nuk e ndajmë dot këtu. Megjithatë kërkohet lënia në fuqi e vendimit të KZAZ-së dhe të rrëzoni kërkesën ankimore si të pabazuar në ligj. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Përfundimisht nga ana e KQZ-së kërkohet?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

**Z. M. Bardhi:** Në përfundim të këqyrjes së provave të materialeve dhe sa u relatua në seancë, kërkojmë rrëzimin e kërkesës ankimore nr.11, si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe lënien në fuqi të vendimit nr.85 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë Himarë”. Faleminderit!

**Z. K. Bele:** Në këtë fazë KAS do të tërhiqet për vendim dhe do ta japim vendimin në orën 12.00. Ne po tentojmë ta shpallim vendimin në orën 12.00, nëse do kemi ndonjë vonesë për arsye të debatit, do ju njoftojmë, por si orar do jetë ora 12.00. Faleminderit! Me kaq e mbyllim seancën.

**Rifillon seanca**

**Ora 12:02**

**Z. K. Bele:** Riçelim seancën. Jemi të pestë prezent, për efekt procesverbali, KAS ka qenë me katër anëtarë në sallë dhe anëtari i pestë është online. Në përfundim të diskutimit dhe shqyrtimit të provave, të diskutimit të çështjes në tërësi, KAS mbështetur në nenet 21 dhe 143 të ligjit 1019, datë 29.12. “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, KAS vendosi: rrëzimin e kërkesës ankimore nr.11, datë 9.08.2024, të subjektivit zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, lënien në fuqi nr.85, datë 5.08.2024, të KZAZ-së nr.88 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve, për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Himarë”, në zgjedhjet e pjesshme të datës 4.08.2024. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendor të Zgjedhjeve. Bazuar në pikën 1, të nenit 45 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda 5

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt. 26.08.2024*

(pesë) ditëve nga shpallja e tij. U shpall sot më datë, 26.08.2024. Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr.19**

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

